



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Datë/a:	14.05.2019
Referenc-ë:	Propozimi i menaxherit te kontratës për ndërprerjen e kontratës numër 616 18 135 121
Për	Kryesi i punëve Ndërmarrja Tregtare Grafike " Blendi " dhe Nazife Krasniqi ,menaxhere e projektit;
CC:	Ardian Olluri, Drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm
Nga/ Od/ From:	Zekë Bardhaj, Udhëheqës i Departamentit te Prokurimit
Tema/ Subjekat/Subject	Marrëveshje për ndërprerjen e kontratës

Në bazë të Propozimit nga referenca të Personave të Autorizuar për mbikëqyrje të realizimit të kontratës dhe duke u bazuar në nenin 26.1 dhe 26.2(pika a,d dhe f)të Kushteve të Kontratës dhe si dhe duke u bazuar në nenin 61.26,61.27 dhe 61.29 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik që kanë të bëjnë me ndërprerjen e kontratës, Departamenti i Prokurimit merr:

MARRËVESHJE PËR NDËRPRERJE TË KONTRATËS

Furnizimi dhe montimi i rafteve për Arkivin e Drejtorisë së Urbanizmit - Komuna e Prishtinës

me numër 616 18 135 121

I. ANULOHET kontrata me Operatorin Ekonomik Ndërmarrja Tregtare Grafike " Blendi " lidhur me aktivitetin me titull: Furnizimi dhe montimi i rafteve për Arkivin e Drejtorisë së Urbanizmit - Komuna e Prishtinës, me nr. të prok: 616 18 135 121 e lidhur me datë: 25.01.2019.

II. Vërtetohet: Operatori Ekonomik Ndërmarrja Tregtare Grafike " Blendi " dhe Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës me vullnet të dyanshmëm deklarohen për shkëputje të kontratës.

ARSYETIM

Organi mbikëqyrës, i caktuar sipas vendimit të cekur më lartë, është njoftuar përmes postës elektronike të datës 15.02.2019, për nënshkrimin e kontratës "Furnizimi dhe montimi i rafteve për Arkivin e Drejtorisë së Urbanizmit-Komuna e Prishtinës", me numër identifikues 616 18 135 121, dhe për caktimin e menaxherit dhe mbikëqyrësve të kontratës, në përbërje të zyrtarëve të Drejtorisë së Urbanizmit - Nazife Krasniqi, menaxhere e kontratës, dhe Bahtije Uka e Berim Osmanaj, mbikëqyrës të kontratës, duke pranuar të bashkëngjitur edhe kopjen e kontratës në fjalë dhe të vendimit për

caktimin e organit mbikëqyrës. Organi mbikëqyrës, pas njoftimit, pranimit dhe analizimit të kontratës, ka mbajtur takimet konsultative dhe shqyrtuese (me datë 20.02.2019, 25.02.2019) me menaxherin e kontratës Agron Deva, nga kompania kontraktuese, ku është diskutuar dhe janë konstatuar disa mangësi në specifikimet e dosjes së tenderit, përkatësisht sipas paramasës në *Pjesa II. Përshkrimi i çmimeve*, të kësaj kontrate, nuk është përshkruar se raftat e paraparë të vendosen në kuadër të hapësirës, duhet të lëvizin me mekanizimin përkatës-me rrota, dhe se lartësia, sipas gjendjes faktike, pamundëson montimin e raftave, të cilët janë paraparë të kenë lartësi H=2.65 m`.

Organi mbikëqyrës, pas takimeve të mbajtura dhe konsultimit edhe me zyrtarët e Zyrës së Prokurimit, ka vlerësuar se me qëllim të funksionimit normal të hapësirës së arkivit, duhet që raftat të kenë edhe mekanizmin lëvizës, ndërsa lartësia e raftave duhet të ulet, për shkak të gjendjes faktike dhe standardit prodhues. Lidhur me këtë, kompania kontraktuese, pas hulumtimit të tregut vendor dhe atij të jashtëm, përmes postës elektronike të datës 07.03.2019, ka kërkuar nga organi mbikëqyrës miratimin e shtyrjes së afatit për furnizim, me arsyetimin se materiali i kërkuar nuk gjendet në tregun vendor, dhe i njëjti duhet të importohet nga jashtë vendit. Në përgjigje të kësaj kërkesë, organi mbikëqyrës ka kërkuar nga kompania kontraktuese, që paraprakisht vendosjes lidhur me këtë çështje, të prezantojë certifikatën mbi cilësinë e materialeve - rafteve dhe mekanizmit lëvizës, dhe më pas të hartohet Plani për Menaxhimin e Kontratës, bazuar në nenin 81.2 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik. Me datën 28.03.2019, organi mbikëqyrës njoftohet nga kompania kontraktuese se certifikata mbi cilësinë e materialeve nuk është siguruar nga prodhuesi, duke theksuar se ky kriter (për dorëzimin e certifikatës në fjalë) nuk ka qenë në dosjen e tenderit.

Më pas, organi mbikëqyrës i kontratës, pas shqyrtimit të njoftimit për mos pranim të atesteve dhe certifikatave të materialeve të referuara si më lartë, duke u bazuar në nenin 3, pika 3.1 të kontratës "Furnizimi dhe montimi i rafteve për Arkivin e Drejtorisë së Urbanizmit - Komuna e Prishtinës", me numër identifikues 616 18 135 121, e nënshkruar me datë 25.01.2019, ku thuhet se, citoj: "*Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës*", përmes kërkesës së parashtruar përmes postës elektronike, me datë 04.04.2019, ka kërkuar nga kontraktuesi që në afatin prej 7 (shtatë) ditësh kalendarike, të dorëzojë atestet e larcekura, në të kundërtën do të vazhdohet me fillimin e procedurës për ndërprerjen e kontratës në fjalë.

Andaj ju nuk u jeni përgjegjur asnjëherë kërkesave të tilla dhe bazuar në kërkesën e menaxherit rrjedh se nuk ka gjasa për vazhdim të furnizimeve dhe në këtë bazë, kontrata konsiderohet e ndërprerë dhe e njëjta nuk ka me asnjë efekt juridik.

Pas njoftimit të Operatorit Ekonomik me datë 02.05.2019 për ndërprerje të kontratës me pëlqim ndërprerje, palët e pa kënaqura mund të drejtohen për zgjedhjen e kontesteve në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

Zekë Bardhaj
Udhëheqësi i Departamentit të Prokurimit



Blend Rama
Operatori Ekonomik



Shtojcë:

1. Propozimi i menaxherit dhe komunikimet e të njëjtit me punëkryesin.
2. Email zyrtar nga Operatori Ekonomik për shkëputje të kontratës me pëlqim të dyanshëm

Vendimi i dërgohet:

Furnizuesit,
Menaxherit të projektit;
Drejtorisë për Urbanizëm; dhe
Departamentit të Prokurimit